



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTARE

PROJEKT BUXHETI 2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTARE

Nr. 1058/Prot.
1

Tiranë, më 28 / 08 / 2015

VENDIM Nr 22

Këshilli Drejtues në mbledhjen e tij, të datës 28 / 08 / 2015, pasi shqyrtoi materialin e përgatitur për Projekt – Buxhetin e vitit 2016, nga Njësia e Buxhetit, Raportimit Statistikor dhe Financës,

VENDOSI:

1.- Të miratojë Projekt – Buxhetin e vitit 2016, të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare me treguesit si më poshtë:

- Të ardhura 253,454.000 lekë
- Shpenzime 253,454.000 lekë

2.- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI DREJTUES

1. Zj. Kamelia VOJKA

Kryetare

2. Zj. Vali BIZHGA

Anëtare

3. Zj. Mimoza DHËMBI

Anëtare

4. Z. Tomi FRASHËRI

Anëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTARE

Nr. 458 Prot.

Tiranë, më 31/08/2015

Lënda: Dërgimi i projekt-buxhetit të vitit 2016 të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare (D.SH.Q)

Drejtuar: Ministrisë së Financave
T I R A N Ë

Në zbatim të legjislacionit në fuqi "mbi hartimin dhe miratimin e projekt-buxhetit", bashkëlidhur kësaj shkrese po ju dërgojmë dosjen e projekt-buxhetit të vitit 2016-të të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare. Materialet e përfshira në dosje janë si më poshtë:

1. Raporti përmbledhës i projekt-buxhetit.
2. Pasqyrat shoqëruese të projekt-buxhetit.
3. Propozimet për projektet e investimeve.
4. Vendimi i Miratimit të projekt-buxhetit të vitit 2016 i Këshillit Drejtues të D.SH.Q-së.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,


Kamelia VOJKA
DREJTORE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTARE

Nr. 458 Prot.

Tiranë, më 31 / 08 / 2015

Lënda: Dërgimi i projekt-buxhetit të vitit 2016 të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare (D.SH.Q)


Drejtuar: Z. Engjëll AGAÇI
Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave
T I R A N Ë

I nderuar zoti Sekretar i Përgjithshëm,


Në zbatim të legjislacionit në fuqi "mbi hartimin dhe miratimin e projekt-buxhetit", bashkëlidhur kësaj shkrese po ju dërgojmë dosjen e projekt-buxhetit të vitit 2016-të të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare. Materialet e përfshira në dosje janë si më poshtë:

1. Raporti përmbledhës i projekt-buxhetit.
2. Pasqyrat shoqëruese të projekt-buxhetit.
3. Propozimet për projektet e investimeve.
4. Vendimi i Miratimit të projekt-buxhetit të vitit 2016 i Këshillit Drejtues të D.SH.Q-së.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,


Kamelia VOJKA
DREJTORE

Rezultati ekonomik-financiar i DSHQ-së nga viti 2000 deri në vitin 2015, në 000/lekë



PËRMBAJTJA

- 1 Hyrja**
- 2 Parimet e DSHQ-së**
- 3 Prioritetet e DSHQ-së për vitin 2016**
- 4 Garancitë që ofron buxheti i vitit 2016**
- 5 Analiza e të ardhurave ndër vite dhe parashikimi për vitin 2016**
- 6 Analiza e shpenzimeve ndër vite dhe parashikimi për vitin 2016**
- 7 Programimi i investimeve dhe subvencionet për vitin 2016**

Projekt buxhetit të vitit 2016, është hartuar duke u mbështetur në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012, "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit", Udhëzimin nr.8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Udhëzimin Nr. 8/1, datë 9.7.2015 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018”, realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të viteve 2013, 2014 dhe realizimit të 6-mujorit të I-rë të vitit 2015.

Gjithashtu, projekt buxheti i vitit 2016 është hartuar duke marrë në konsideratë të gjithë mekanizmat e buxhetimit me pjesëmarrje, si përcaktim i qartë i objektivave sektoriale, vendosje e prioriteteve mbështetur në nevojat dhe kërkesat që vijnë direkt nga sektorët, njësitë, qendrat dhe pallatet.

I gjithë ky proces, tashmë i konsoliduar në vite e i bazuar në praktikën e buxhetimit me pjesëmarrje, bazohet në parimin e Gjithëpërfshirjes së Njësive, Qendrave e Sektorëve. Eksperienca dhe praktikat e akumuluar gjatë këtyre viteve si edhe të gjithë mekanizmat e marrjes së informacionit dhe propozimit të vendimeve të Sektorëve dhe Njësive vijnë të kontribuojnë në hartimin e buxhetit. Kështu, edhe gjatë këtij viti Sektorët dhe Njësitë vijuan të përfshihen në procesin e hartimit të buxhetit, duke shprehur kërkesat dhe nevojat e tyre për realizimin me sukses të objektivave që ka Institucioni Ynë, duke dhënë mendime për përmirësimin e cilësisë së shërbimit e ambjenteve, duke përcaktuar masa konkrete për uljen e shpenzimeve dhe rritjen e të ardhurave. Ky proces është realizuar nga ana e Përgjegjësve të Sektorëve, Drejtoreve, Njësive, Përgjegjësve të qendrave dhe Përgjegjësve/Drejtorëve të pallateve duke analizuar realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitit 2014, të prithshmin 2015 dhe parashikimin për 2016. Për referencë shkresa me Nr. 409 Prot., datë 27.7.2015 e Njesisë së Buxhetit, Raportimit Statistikor dhe Financës dhe përgjigjet e kthyer nga Njësitë.

Në mënyrë të përgjithshme procesi i hartimit të buxhetit synon:

- Transparencë në administrimin e të ardhurave përmes raportimeve të vazhdueshme pranë Këshillit Drejtues, Institucioneve të varësisë dhe institucioneve të tjera të përfshira sipas ligjeve në fuqi.
- Vendimmarrje të përbashkët mbi prioritetet e zhvillimit të Institucionit;
- Orientim të burimeve financiare, me qëllim realizimin e objektivit “Shërbim sa më cilësor kundrejt shpenzimeve optimale”;
- Buxhet gjithëpërfshirës që konsideron dhe kërkesat e personaliteteve, personave dhe institucioneve që përfitojnë shërbimin tonë.

2. Parimet e DSHQ-së

- Ofrimi i një shërbimi cilësor konform standardeve më të larta bashkëkohore;
- Zhvillim të veprimtarisë së hotelarisë, me qëllim arritjen e suksesit financiar;
- Miradministrimin e qiradhënies së aseteve të Institucionit dhe uljen e tepricave të mbartura në vite të debitorëve si klientë ashtu dhe furnitorë;

- Kryerjen e investimeve me qëllim kthimin e vilave dhe rezidencave në ambjente komode bashkëkohore, përfshire këtu ambjentet e brendshme dhe të jashtme të tyre, por kryesisht ato objekte që gjenerojnë të ardhura, apo dekorimin e gjelbërimit e kopshteve;
- Hartimin dhe zbatimin e politikave/proceseve që dëshmojnë dhe sigurojnë integritet, drejtësi e ndershmëri si në marrëdhëniet e brendshme dhe ato të jashtme, për nga pikëpamja financiare, por jo vetëm.

3. Prioritetet e DSHQ-së për vitin 2016

- Rritja e të ardhurave,
- Ulja e shpenzimeve operative,
- Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të menaxhimit të shpenzimeve,
- Rritja e investimeve në mbështetje të kërkesave dhe standardeve bashkëkohore të Vilave e Rezidencave Qeveritare, dhe Pallateve,
- Krijimi i një klime të përshtatshme dhe nxitëse për biznesin përmes shfrytëzimit të kapaciteteve ekzistuese të DSHQ-së dhe krijimit të burimeve të reja, me qëllim shtimin e të ardhurave të veta të institucionit.
- Zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të data-bazë-s së të dhënave ekonomiko-financiare për çdo objekt nën administrimin e DSHQ-së,
- Implementimi i projektit të agjencisë së udhëtimi për përqendrimin e prerjes së biletave të udhëtimeve ajrore për të gjitha institucionet shtetërore dhe entet e varësisë me qëllim shtimin e të ardhurave të DSHQ-së, ndihmesën në zbatimin e programit të qeverisë në luftën kundër korrupsionit dhe uljen në mënyrë të ndjeshme në buxhetin e shtetit për *zërin shpenzime për udhëtime (ajrore)*,
- Implementimi i projektit të agjencisë së pastrimit dhe gjelbërimit të përqëndruar, për mbajtjen në nivel të parametrave higjieno-sanitar të institucioneve shtetërore dhe enteve të varësisë me qëllim përmirësimin e sipërfaqeve të gjelbërta të territoreve përreth këtyre institucioneve,
- Përmirësimin e situatës në Qendrën e Transportit dhe Parkut të Delegacioneve të DSHQ-së nëpërmjet zëvendësimit pjesë-pjesë të mjeteve të transportit, shitjes nëpërmjet ankandit të mjeteve tip benz të papërdorshme për shkak të vjetërsisë së prodhimit dhe amortizimit të tyre ose kategorizimin e tyre *në vlera relike* dhe muzeale si dhe ripërtëritjes së mjeteve të parkut të delegacioneve (nëpërmjet leasing ose kredi të zbutur, kjo konform ligjit të ndërmarrjeve) me qëllim eliminimin e përkeqësimit të gjendjes financiare që situata aktuale shkakton në këtë sektor.

Programi financiar për vitin 2016 bazohet në analizën e kostove të shërbimeve në tre vitet e fundit dhe në objektivin për rritjen e standardeve dhe cilësisë së shërbimeve. Këto analiza janë shoqëruar me zbatimin e metodave më të fundit të buxhetimit, të cilat garantojnë zbatimin e politikave të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të burimeve financiare, në përputhshmëri me ecurinë e shpenzimeve faktike, me parashikimet në buxhetin afatmesëm dhe me ndikimin e programeve të ndryshme të zhvillimit ekonomik të DSHQ-së.

Teknikat e përdorura për hartimin e buxhetit janë:

- ❖ Përgatitja e buxhetit bazuar në detyra/program. Kjo formë parashtron një klasifikim të ri të aktiviteteve (detyrave);
- ❖ Përgatitja e buxhetit të balancuar. Kjo formë detyron formulimin e qartë të prioriteteve në çdo nivel.

4. Garancitë që ofron buxheti i vitit 2016

- Konkretizon në terma financiare hapat e ndërmarra për zbatimin e politikave të mbajtjes të pandryshuar të shpenzimeve në funksion të rritjes së të ardhurave dhe për pasojë rritjes së investimeve për mirëmbajtjen e objekteve,
- Përmbushjen e kërkesave dhe prioriteteve të personaliteteve të larta shtetërore dhe të huaj që përfitojnë nga shërbimi Ynë,
- Sigurimin e transparencës maksimale përgjatë kryerjes së shpenzimeve për mallra e materiale,
- Rritjen e të ardhurave nga shifra e afarizmit,
- Rritjen e investimeve për kthimin e mjediseve në nivele bashkëkohore, kjo dhe në mbështetje të kërkesave të përdoruesve,
- Kontroll më efikas në përdorimin e fondeve (subvencionit për shfrytëzim dhe të ardhurave të veta) si dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të menaxhimit të shpenzimeve.

Njësitë pjesëmarrëse në Buxhetin Vjetor janë:

- 1) Aparati i Administratës së Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare,
- 2) Njësite,
- 3) Qendrat,
- 4) Sektorët,
- 5) Vilat, dhe
- 6) Pallatet.

Modeli i Parashikimit Financiar (të ardhura dhe shpenzime) për vitin 2015 mbështetet në:

- ◆ Viti 2013
 - Të ardhurat totale të realizuara në vitin 2013,
 - Shpenzimet totale të realizuara për vitin 2013;
- ◆ Viti 2014
 - Të ardhurat totale të realizuara në vitin 2014,
 - Shpenzimet totale të realizuara për vitin 2014;
- ◆ Viti 2015
 - Pritshmëritë mbi të Ardhurat për vitin 2015,
 - Pritshmëritë mbi Shpenzimet për vitin 2015,
 - Të ardhurat e realizuara për 6/mujorin e parë 2015,
 - Shpenzimet e realizuara për 6/mujorin e parë 2015;
- ◆ Viti 2016
 - Parashikimi i të Ardhurave për vitin 2016,
 - Parashikimi i Shpenzimeve për vitin 2016,

- Parashikimi i Investimeve;
- ◆ Treguesit e Buxhetit.

5. Analiza e të ardhurave ndër vite dhe parashikimi për vitin 2016

Për vitin 2016, të ardhurat e përgjithshme të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare parashikohen në shumën 253,454 mijë lekë ose 2,446 mijë lekë më shumë se i pritshmi i vitit 2015. Të ardhurat janë programuar në mënyrë të tillë që të përballojnë shpenzimet parashikuara për këtë vit.

Burim i të ardhurave janë:


- Të ardhurat nga qiratë (nga kontratat me afat një ose më shumë vjeçare, nga kontratat me afat një ose më shumë ditë të ambjenteve të Pallatit të Kongreseve, Vila Nr.31, Pallati i Brigadave),
- Të ardhurat nga hoteleria,
- Të ardhurat nga Shërbimet (pritje përcjelljet e personaliteteve të larta shtetërore vendas dhe të huaj),
- Të ardhurat nga Subvencioni i Shtetit (pjesa e subvencionit për shpenzime operative për ato veprimtari që nuk gjenerojnë të ardhura),
- Të ardhura nga punime dhe shërbime të tjera,
- Të ardhura nga kuota të pjesëmarrjes së subvencionit për investime,
- Të ardhura nga Burime të tjera.

Duke ju referuar të dhënave statistikore të buxhetit në vite, të ardhurat e shprehura me shifra, evidentohen në tabelën që vijon:

TË ARDHURAT		(000) lekë				
Nr.	Përshkrimi	Real 2013	Real 2014	Parash 2015	Realiz 6/muaj 2015	Parash 2016
1	Nga Qiratë	61,700	63,235	76,000	30,335	73,000
2	Nga hoteleria	516	194	700	3	634
3	Nga shërbimet(pritje përcj)	13,965	24,187	21,000	12,139	22,000
4	Subvencioni i shtetit	88,600	89,746	90,000	46,000	94,202
5	Nga punime dhe shërbime të tjera	5,811	6,953	6,600	3,665	6,910
6	Kuota pjesëmarrje sub.për invest	46,231	42,468	49,708	24,854	49,708
7	Të ardhura nga burime të tjera	3,495	4,970	7,000	9,623	7,000
	Totali	220,318	231,753	251,008	126,619	253,454

Raporti i të ardhurave shprehur në mënyrë grafike nga viti 2013-2014, të pritshmin e vitit 2015, përfshirë edhe parashikimin për vitin 2016, paraqitet si vijon:

(000) lekë



Në mënyrë të detajuar, në vijim analizohet çdo zë i të ardhurave:

A. Të ardhurat nga qiratë për vitin 2016, parashikohen në vlerën 73 000 mijë lekë. Ka një ulje në krahasim me parashikimin për vitin 2015, pasi nga analiza që i bëhet realizimit të dy viteve paraardhëse dhe 6/mujorit të parë të vitit 2015, pavarësisht punës së mirë të bërë në këtë drejtim nga stafi i DSHQ-së, asnjëherë nuk është realizuar vlera 76 000 mijë lekë.


E ardhura kryesore nga ky zë realizohet nga dhënia me qira e ambjenteve të Pallatit të Kongreseve. Përafërsisht gjysma e ambjenteve të këtij objekti është zënë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i cili nuk paguan qira. Nga përllogaritjet kryer nga specialistët e DSHQ-së, e ardhura e munguar nga mos marrja e qirasë nga ky institucion, llogaritet në vlerën 50 702 mijë lekë në vit.

Megjithëse me Vendimin e Këshillit të Ministrave të datës 30 korrik 2014, është vendosur zhvendosja e KQZ-së nga Pallati i Kongreseve dhe akomodimi i saj në një ambient tjetër. Për shkak të kohës së papërcaktuar të largimit, shpenzimet për kryerjen e rikonstruksionit ose meremetimeve që do të kërkohen për përshtatjen e për dhënien e tyre një qiramarrësi tjetër, nuk janë parashikuar në të ardhurat e vitit 2015.

Gjithashtu një ndikim negativ në realizimin e pritshëm të këtij zëri ka dhënë dhe ndërprerja e kontratës së qirasë për Vilat Gjermane me subjektin Tirana International School.

Në mënyrë grafike të ardhurat nga dhënia me qira e aseteve në kujdestari të DSHQ-së ndër vite dhe parashikimi për vitin 2016, jepet si vijon:

(000) lekë




B. Të ardhurat nga hoteleria për vitin 2016 parashikohen në vlerën 634 mijë lekë. Për 6/mujorin e parë të vitit 2015 është realizuar një e ardhur prej 3 mijë lekë. Nisur nga analiza e këtyre treguesve rezulton që në parashikimin e vitit 2016, për këtë zë të ardhurash, ka një ulje prej 66 lekë krahasuar me parashikimin e bërë për vitin 2015, kjo për arsye se realizimi i të ardhurave nga ky zë në 3 vite, është në vlera shume të ulëta.

Kjo ka ndodhur për shkak të degradimit të mjediseve të përcaktuara për këtë qëllim, pasi nuk janë mirëmbajtur dhe nuk janë kryer investime për to si dhe për faktin që sipas bazës ligjore mbi të cilën zhvillohet veprimtaria e DSHQ-së, nuk mund të lejohet përdorimi i këtyre mjediseve nga persona që janë jashtë klasifikimit të përcaktuar për ti shfrytëzuar ato.

C. Të ardhurat nga shërbimet (pritjet e përcjelljet) për vitin 2016 parashikohen në vlerën prej 22 000 mijë lekë ose 1 000 mijë lekë më shumë se i pritshmi i vitit 2015.

Në mënyrë grafike realizimi i të ardhurave nga pritje-përcjelljet paraqitet si vijon:

(000) lekë




Shënim: realizimi në vitin 2014, ka qenë pak më i lartë për shkak të festimeve të 70 vjetorit të Çlirimit të vendit, ceremoni e kryer në Pallatin e Kongreseve dhe e financuar nga buxheti i shtetit.

Nga analiza e grafikut të mësipërm vërehet një tendencë në rritjen e të ardhurave nga ky zë, pavarësisht se kjo nuk varet nga puna direkte e Institucionit tonë por nga kërkesa për këtë shërbim nga ana e Institucioneve të tjera.

Për të ardhmen, me qëllim rritjen e të ardhurave nga shërbimet, duhet studiuar edhe zgjerimi i kësaj veprimtarie duke ofruar shërbim edhe për disa biznese private (banka, organizata të ndryshme jo fitimprurëse si dhe kompani të tjera të rëndësishme).

Ç. Të ardhurat nga punime dhe shërbime të tjera ku përfshihen të ardhurat nga parkimet dhe delegacionet, parashikohen të jenë në vlerën 6 910 mije lekë ose 310 mijë lekë më shumë se i pritshmi 2015, kjo për shkak të blerjes të tre mjeteve të reja gjatë vitit 2014. Për shkak të përmirësimit të performancës në këtë drejtim kemi dhe rritje të kërkesës për marrjen me qira të këtyre mjeteve.

Në mënyrë grafike të ardhurat e realizuara nga viti 2013-2014, i pritshmi 2015 dhe parashikimi për vitin 2016 paraqiten si më poshtë:




D. Të ardhurat nga burime të tjera (në këtë zë të ardhurash përfshihen: pagesat për të tretët ujë, drita, energji elektrike, shërbime tapicerie, rrobaqepësi dhe foto për nuse në Pallatin e Brigadave).

Në kontratat që lidhen për dhënien me qira të ambjenteve, detyrimet për pagesën e konsumit të shërbimeve të lartpërmendura merren përsipër nga vetë klienti, për vitin 2016, duke ju referuar statistikës së viteve të mëparshme dhe parashikimit të aktiviteteve që do të zhvillohen në Pallatin e Kongreseve (ku qiramarrësit i marrin përsipër vetë shpenzimet për energji elektrike), si dhe kontratës aktuale që kemi me KQZ-në për energjinë elektrike, këto të ardhura i kemi parashikuar në vlerën **7 000 mije lekë në të njëjta nivele me të pritshmin e vitit 2015.**

Në mënyrë grafike të ardhurat nga zëri i *“Te ardhurave nga burime të tjera”* paraqiten si vijon:

(000) lekë




E ardhura nga shifra e afarizmit, që përfaqëson punën konkrete të DSHQ-së për vitin 2016 parashikohet në vlerën 109,544 mijë lekë ose 3 244 mijë lekë më shumë se i pritshmi i vitit 2015.

000/leke

Nr.	Parashikimi	Realiz	Realiz	I pritshmi	Parash
		2013	2014	2015	2016
1	Nga Qiratë	61,700	63,235	73,000	73,000
2	Nga hoteleria	516	194	700	634
3	Nga shërbimet(pritje përcj)	13,965	24,187	21,000	22,000
4	Nga punime dhe shërbime te tjera	5,811	6,953	6,600	6,910
5	Të ardhura nga burime të tjera	3,495	4,970	7,000	7,000
	Totali	85,487	99,539	108,300	109,544

Në mënyrë grafike të ardhurat e realizuara nga shifra e afarizmit(të ardhurat e veta paraqiten si vijon)



Pavarësisht përmirësimeve të reflektuara në realizimin e të ardhurave në 6/ mujorin e I-rë të vitit 2015, dhe parashikimeve me tendence përmirësimit real në krijimin e të ardhura të veta

planeve të reja të biznesit, zgjerimi i veprimtarisë si dhe bashkëpunimi me kompani serioze private që paraqesin interes për përdorimin e ambjenteve tona për kryerjen e eventeve të organizuara nga ana e tyre.

Në zbatim të VKM-së nr.5 datë 04/01/2012 “Për një ndryshim në vendimin nr.34 datë 07/01/1999 të Këshillit të Ministrave “Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe Trajtimin e Personaliteteve të Larta”, të ndryshuar, ku përcaktohet që “Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare është person Juridik në vartësi të Kryeministrit. Ajo e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin për ndërmarrjet, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare financohet nga të ardhurat e siguruar nga veprimtaria e saj dhe nga buxheti i shtetit”, për përballimin e shpenzimeve është planifikuar edhe subvencioni për shpenzimet korrente për vitin 2016 në vlerën 94 202 mijë lekë, ky subvencion është llogaritur për atë pjesë të veprimtarisë që nuk gjeneron të ardhura; vlera e subvencionit të kërkuar nga shteti për shpenzime korrente është parashikuar 4 202 mijë lekë më shumë se në vitin e kaluar pasi në të janë përfshirë edhe shpenzimet për stafin dhe shpenzimet e tjera të parashikuara për tu mbuluar nga shteti sipas VKM-së me Nr.463, datë 27.5.2015 “Për një ndryshim në Vendimin nr.34, datë 7.1.1999, të Këshillit të Ministrave “Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe Trajtimin e Personaliteteve të Larta”, të ndryshuar, dhe për një shtesë në buxhetin e vitit 2015 për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare”, për trajtimin e ish Presidentëve.

Të ardhurat nga kuota pjesëmarrje sub.për investime për vitin 2016 parashikohen në vlerën 49 708 mijë lekë, vlerë për parashikimin e të cilës i kemi referuar investimeve që janë programuar për t’u realizuar në vitin 2015.

Në përmbyllje, për rritjen e treguesit të ardhura, për vitin 2016, do të punohet në drejtim të:

- Rritjes së aftësive menaxhuese përmes një procesi më të mirë të rekrutimit, selektimit dhe trajnimit të stafit.
- Implementimi i planeve të reja të biznesit.
- Vendosja e tarifave të reja për mjediset që kërkojnë për t’u marrë më qira.

6. Analiza e shpenzimeve ndër vite dhe parashikimi për vitin 2016

Për vitin 2016 shpenzimet e përgjithshme të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare parashikohen në vlerën 253 454 mijë lekë, 2 446 mijë leke më shumë se i pritshmi i vitit 2015, pra në të njëjtin nivel me rritjen e të ardhurave të programuara për këtë vit. Kjo për shkak të përmirësimit të kushteve në vila dhe rezidenca nëpërmjet kryerjes së riparimeve të lehta, lyerjeve, disifektimeve si dhe zëvendësimit të disa pajisjeve dhe orendive, uniformave, seteve të servirjes, mjeteve të punës të cilat janë plotësisht ose pjesërisht të amortizuara, duke krijuar kështu probleme serioze në funksionimin normal të punës së DSHQ-së.

Zërat e parashikuara të shpenzimeve janë:

- Shpenzime për paga,
- Shpenzime për sigurime shëndetësore dhe shoqërore,
- Shpenzime për dieta,

- Shpenzime materiale, (përfshihen te gjitha shpenzimet për mirëmbajtjen e objekteve, makinave, pajisjeve, detergjentet
- Shpenzime ushqimore, (përfshihen shpenzimet për pritje përcjelljen)
- Shpenzime për energji elektrike,
- Shpenzime për ujë,
- Shpenzime për telefon,
- Amortizimi i AQT-ve,
- Shpenzime të tjera (përfshijnë shpenzime për këmbim valute, penalitetet, gjoba, taksat vendore të pasurisë, botime në shtyp, instalime kompjuteri, prime sigurimi, abonime, paga të fituara në gjyqe dhe pagesa detyrimi të mbartura ndaj furnitorëve).

Duke ju referuar të dhënave statistikore të buxhetit në vite, shpenzimet e shprehura me shifra, evidentohen në tabelën që vijon:

SHPENZIMET		(000)/lekë				
Nr.	Përshkrimi	Real 2013	Real 2014	Parash 2015	Realiz 6/muaj 2015	Parash 2016
1	Pagat	117,325	98,319	105,328	48,461	108,089
2	Sig shoqërore&shëndetësore	19,532	16,441	17,463	6,827	18,050
3	Udhëtime dhe dieta	2,397	716	2,000	729	2,000
4	Shpenzime materiale	11,658	10,730	28,331	6,286	30,215
5	Shpenzime ushqimore	6,126	12,240	11,743	7,000	13,000
6	Energji Elektrike	11,195	13,934	13,000	7,616	15,000
7	Ujë	6,763	5,586	7,500	2,747	7,500
8	Telefon	2,485	1,539	2,000	754	1,600
9	Amortizim i AQT-ve	47,554	44,025	51,000	25,500	51,000
10	Shpenzime të tjera	8,227	13,574	12,643	3,894	7,000
	Totali	233,262	217,105	251,008	109,813	253,454

Në parashikimin e shpenzimeve të vitit 2016, jemi referuar shpenzimeve faktike të kryera në vitet 2013 dhe 2014, shpenzimeve të 6/mujorit të parë të vitit 2015, të pritshmit të po këtij viti dhe kërkesave të paraqitura nga Njësitë, Sektorët, Qendrat dhe Pallatet.

Rritja kryesisht këtë vit është tek shpenzimet industriale, ku përfshihen pajisjet dhe materialet që shërbejnë për mirëmbajtje.

1. Shpenzimet për zërin paga dhe sigurime shoqërore & shëndetësore parashikohen:


-Për pagat në vlerën 108 089 mijë lekë. Përllogaritja është bërë duke ju referuar realizimit faktik ndër vite, numrit të ndryshuar të punonjësve si dhe është përfshirë njëkohësisht shtesa në strukturë e 4 sekretareve dhe 1 pastrueseje për shërbimin ndaj ish Presidentëve.

Gjithashtu është kërkuar një rritje e fuqisë punëtore (prej 3 punëtoresh provizorë), gjatë sezonit të verës, kryesisht për vilat rezidenciale, për shkak të shtimit të frekuentimit të këtyre ambjenteve në këtë sezon, ku vlen të theksojmë se kjo rritje nuk do të ketë efekt të madh financiar duke qenë se pagat janë llogaritur për kategorinë e V-të (më të ultën).

-Shpenzimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore për vitin 2016, janë parashikuar në vlerën 18 050 mijë lekë. Vlera është llogaritur duke ju referuar fondit të pagës bruto dhe legjislacionit në fuqi për masën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që duhet të paguaj punëdhënësi (16.7% mbi fondin e pagave).

3. Shpenzimet për zërin udhëtime dhe dieta, janë parashikuar në vlerën prej 2 000 milion lekë , në të njëjtën masë me të pritshmin e vitit 2015 dhe faktit të 6/mujorit të parë të vitit 2015.

Në mënyrë grafike ky zë shpenzimesh paraqitet si vijon:



Sikurse u theksua dhe më herët në këtë draft, pavarësisht parashikimit dhe kontrollit të vazhdueshëm që kryhet në drejtim të uljeve të shpenzimeve për udhëtime dhe dieta, veprimtaria e DSHQ-së kushtëzohet nga lëvizjet dhe shërbimet që kërkohen nga personalitetet e larta të cilëve u ofrojmë shërbimin tonë.

4. Në parashikimin e shpenzimeve industriale është marrë parasysh:

- *-Kërkesat e paraqitura nga sektorët dhe njësitë për këto lloj materialesh/mallrash
- *-Parashikimit të rritjes së aktivitetit të DSHQ-së (nga futja në funksion i objekteve të rikonstruara në vitet e fundit)

Në mënyrë të detajuar zërat dhe vlerat përkátëse për këtë grup shpenzimesh jepen në pasqyrën

Nr	Emërtimi	Shpenzime industriale
		Parashikimi i shpenzimeve industriale për vitin 2016 në leke
1	Gaz djegës +lëndë drusore	100,000
2	Materiale ndërtimi dhe vegla pune ndërtimi	1,403,450
3	Materiale elektrike	771,150
4	Materiale hidraulike dhe gaz për fikse zjarri	804,700
5	Baze materiale, pleh dhe aksesore për gjelbërimin	1,106,000
	Pajisje në ndihmë të gjelbërimit	391,000
	Preparate të ndryshme për disinfektim, për ambiente të jashtme dhe të brendshme+shërbimi	1,000,000
	Vegla pune për gjelbërimin	270,900
6	Karta abonimi	600,000
7	Pajisje elektron	300,000
8	Kancelari	258,876
9	Tonera	300,000
	Kompjutera, fotokopje, printera dhe skaner	4,530,000
9	Detergjente, artikuj hotelerie dhe pasticerie	3,072,710
10	Pajisje, orendi, elektroshtëpiake, enë dhe mjete kuzhine.	4,000,000
11	Uniforma, doreza, çizme, këpucë dhe veshje pune për punonjësit	3,102,584
12	Pjese këmbimi për automjete	1,200,000
13	Lubrifikante dhe adezive	300,000
14	Goma për automjete	200,000
15	Benzine me tollon për automjete	2,529,600
16	Naftë me tollon për automjete D1	2,502,400
17	Naftë me lëng për kaldaja D1	1,472,000
	Totali lekë	30,215,370

Nga analiza e tabelës së mësipërme rezulton se, vlerën më të madhe të këtij grupi shpenzimesh e zënë karburanti për mjete dhe kaldaja, detergjentët e mallrat në ndihmë të kuzhinës, dhe uniformat e punonjësve, kjo për faktin se gjendja aktuale e tyre është e papërshtatshme dhe ndikon negativisht në performancën e institucionit.

Gjithashtu një vlerë të konsiderueshme në zërin e shpenzimeve, zë edhe nënkategoria shpenzime për pajisje, orendi, elektroshtëpiake, enë dhe mjete kuzhine, për arsye se kërkesat për këto artikuj nga sektorët janë shumë të mëdha, pasi ka mungesa të theksuara, por edhe ato ekzistuese janë të amortizuara së tepërmi.

Njëkohësisht është konsideruar edhe kërkesa e Njësive dhe Pallatit të Brigadave për ripërtëritjen e serës së ndodhur në kopshtin e këtij objekti, që aktualisht është në gjendje tejet

të amortizuar. Propozohet kthimi i saj në gjendje prodhuese buqetash me lule për t'u përdorur në pritje- përcjellje .

Zërat e tjerë janë mbajtur në nivelin e vitit të kaluar dhe programimi për to është bërë duke ruajtur raportin shpenzim produkt.

5. Shpenzimet për artikujt ushqimore, për vitin 2016, parashikohen në vlerën 13 000 mijë lekë ose 1 257 mijë lekë më shumë se parashikimi i vitit 2015. Shpenzimet për këtë zë nuk varen drejtpërsëdrejti nga puna e DSHQ por nga numri i kërkesave për pritje e përcjellje të paraqitura nga Institucionet.

Për këtë arsye dhe programimi i tyre është i pamundur të kryhet me precizion megjithëse rritja e shpenzimeve për mallra ushqimore shoqërohet me rritjen e të ardhurave të zërit *“shërbime për pritje-përcjellje”*. Kjo rritje është bërë duke ju referuar kërkesave në shtim të institucioneve qendrore shtetërore dhe disa kompanive serioze që operojnë në vend për zhvillimin e pritje-përcjelljeve pranë institucionit tonë.

Në mënyrë të detajuar, vlerën e shpenzimit për çdo mall të këtij zëri po e paraqesim në pasqyrën që vijon:

Në lekë		
Nr	Emërtimi	Shpenzime Mallra Ushq
		Parashikimi për vitin 2016 në lekë
1	Mishra (viçi, qingj, gic,etj)	305,580
2	Mish shpendi,sallame, proshuta	48,400
3	Peshk e prodhime deti	1,394,800
5	Verëra të ndryshme (vendi,importi)	1,925,000
6	Pije alkoolike, birra, spumante	388,300
7	Miell, sheqer, oriz, vaj,kripë	610,634
8	Zarzavate	561,000
9	Fruta +Konserva	316,658
10	Bulmetra dhe vezë	699,657
11	Çajra,salep,kakao dhe sheqer me bustina me logo DSHQ	506,000
12	Kafe	1,210,000
12	Prod. pastigerie	1,100,000
13	Pije fresk, redbull, lëngje,ujë,çajra,salep,kakao dhe sheq me pustina me log.DSHQ	3,603,797
13	Fruta të thata,komposto	146,300
14	Erëza të #	110,255
15	Perime,fruta të konservuara,salca të ndryshme	58,782
16	Bukë.	14,837
	Totali mallra ushqimor	13,000,000

5. Shpenzimet për energji, ujë dhe telefon për vitin 2016, parashikohen në vlerën 24 100 mijë lekë.

Në pasqyrën që vijon, paraqiten të dhënat e këtij grupi, të cilat janë parashikuar duke ju referuar shpenzimeve të realizuara ndër vite dhe 6/mujorit të I-rë të vitit 2015.

Në 000/Lekë

Emërtimi i zërit të shpenzimit	Realiz	Realiz	I pritshmi	Parash
	2013	2014	Viti 2015	2016
Energji Elektrike	14,500	13,934	13,000	15,000
Ujë	8,500	5,586	7,500	7,500
Telefon	3,200	1,539	2000	1,600
Totali	26,200	23073	22,500	24,100

Kemi parashikuar një rritje të shpenzimeve për energji elektrike, për shkak të shtimit të aktiviteteve me pasojë konsum të shtuar të energjisë, por që jep efektin pozitiv në rritjen e të ardhurave dhe një pjesë e konsideruar e këtij shpenzimi paguhet nga vetë subjekti që organizon eventin (kryesisht për panairët).

6. Amortizimi i AQT-ve, për vitin 2016, parashikohet në vlerën 51 000 mijë lekë. Ky parashikim është bërë duke ju referuar asetëve ekzistuese dhe atyre të programuara për t'u rikonstruktuar gjatë 6/mujorit të parë të vitit 2015 dhe gjatë vitit 2016.

7. Në zërin shpenzime të tjera, përfshihen shpenzim për këmbim valute, penalitetet, gjoba, taksat vendore, botime në shtyp, instalime kompjuteri, prime sigurimi, abonime, pagesa e pagave ose të çdo dëmshpërblimi tjetër, të fituara në gjyqe si dhe për shlyerjen e një pjese të detyrimit që u kemi furnitorëve ndër vite. Vlera e programuar për vitin 2016 është 7 000 mijë lekë ose 5 643 mijë lekë më pak se viti 2015, pasi institucioni për shkak të ndjekjes me korrektësi të hapave ligjorë, nuk parashikon të marrë penalitete apo gjoba, ose ngarkesa të tjera financiare për shkak të vendimeve gjyqësore në disfavor të Institucionit, kjo gjen pasqyrim qartazi edhe në realizimin e 6/mujorit të parë të vitit 2015. Në këtë vlerë është parashikuar edhe likuidimi i një pjese të tepricave të furnitorëve të mbetura para vitit 2014, pasi në vitin 2014 e në vazhdim po punohet që mos të krijohen teprica të reja.

Përsa më sipër, theksohet fakti se parashikimi i shpenzimeve për vitin 2016, nuk përfshin shpenzimet që synohet të kryhen nga implementimi i projekteve të reja të përmendura më parë në këtë projekt buxhet, pasi për vënien e tyre në zbatim kërkohet edhe angazhimi dhe mbështetja në hallkat e para të organit të vartësisë.

Në përmbyllje, megjithëse shpenzimet parashikohen më të larta se në vitin e kaluar, kjo për arsye jo të mos ndjekjes me korrektesë dhe disiplinë të shpenzimeve, por me qëllimin që të përmirësohen kushtet e mjediseve të brendshme dhe të jashtme të vilave dhe rezidencave në përputhje me standardet e përcaktuara për këto nivele.

Në mënyrë të përmbledhur të ardhurat dhe shpenzimet nga viti 2013- 2014, 6/mujori i I-rë 2015, i pritshmi për vitin 2015 si dhe parashikimi për vitin 2016 të shprehura në 000/lekë paraqiten si në pasqyrën që vijon:


TË ARDHURAT**(000)/lekë**

Nr	Përshkrimi	Real	Real	Parash	Realiz	Parash
		2013	2014	2015	6/muaj 2015	2016
1	Nga Qiratë	61,700	63,235	76,000	30,335	73,000
2	Nga hoteleria	516	194	700	3	634
3	Nga shërbimet(pritje percj)	13,965	24,187	21,000	12,139	22,000
4	Subvencioni i shtetit	88,600	89,746	90,000	46,000	94,202
5	Nga punime dhe shërbime të tjera	5,811	6,953	6,600	3,665	6,910
6	Kuota pjesëmarrje sub.për invest	46,231	42,468	49,708	24,854	49,708
7	Të ardhura nga burime të tjera	3,495	4,970	7,000	9,623	7,000
	Totali	220,318	231,753	251,008	126,619	253,454

SHPENZIMET**(000)/lekë**

Nr.	Përshkrimi	Real	Realizimi	Parash	Realiz	Parash
		2013	2014	2015	6/muaj 2015	2016
1	Pagat	117,325	98,319	105,328	48,461	108,089
2	Sig shoqërore&shendetsores	19,532	16,441	17,463	6,827	18,050
3	Udhëtime dhe dieta	2,397	716	2,000	729	2,000
4	Shpenzime materiale	11,658	10,730	28,331	6,286	30,215
5	Shpenzime ushqimore	6,126	12,240	11,743	7,000	13,000
6	Energji Elektrike	11,195	13,934	13,000	7,616	15,000
7	Ujë	6,763	5,586	7,500	2,747	7,500
8	Telefon	2,485	1,539	2,000	754	1,600
9	Amortizim i AQT-ve	47,554	44,025	51,000	25,500	51,000
10	Shpenzime të tjera	8,227	13,574	12,643	3,894	7,000
	Totali	233,262	217,105	251,008	109,813	253,454

Të ardhurat dhe shpenzimet e tre viteve të fundit si dhe ato të parashikuara për vitin 2016, paraqiten në mënyrë grafike, sa me poshtë vijon:



Pra, të ardhurat dhe shpenzimet janë programuar të balancojnë njëra tjetrën dhe duke ju referuar të dhënave të mësipërme më gjithë tendencën për t'i mbajtur nën kontroll shpenzimet dhe tendencës për rritje të ardhurave, rezulton se subvencioni i shtetit për shpenzime korrente, luan një rol të rëndësishëm në zërin e të ardhurave, pasi aktiviteti i Institucionit tonë kushtëzohet më shumë nga faktor të jashtëm të cilët i kemi përmendur dhe më herët gjatë këtij raporti.

Gjithashtu, lënia pas dore e mjediseve për shume kohë kërkon angazhim serioz për t'i përshtatur këto ambiente, si të brendshme dhe të jashtme, në vende akomodimi bashkëkohore dhe me kushte të përshtatshme, kryesisht sa i përket higjienës dhe pastërtisë.

7. Programimi i investimeve për vitin 2016

Investimet e parashikuara dhe vlera e subvencionit sipas projekteve që propozohet të mbulohet nga buxheti i shtetit për vitin 2016, paraqiten në mënyrë tabelare, si më poshtë vijon:

Në mijë lekë

Emërtimi i projektit të investimit	Vlera e plotë e projektit	Kërkesa Projektbuxhet i 2016	Parashikim i për vitin 2016
Rikons dhe adaptim i ambienteve të Pallat.Kong.për mbledhjen e NATO-PA	308,000	308000	308000
Fazat e projektimit për punimet të rikonstruksionit P.Kongreseve	10,032	10,032	10,032
Mbikëqyrja e punimeve të ndërtimit P.Kongreseve	4,712	4,712	4,712
Kolaudimi i objektit që do të rikonstruktohet P.kongreseve	456	456	456
Fazat e projektit për mobilimin dhe element të interiorit P.Kongreseve	2,888	2,888	2,888
Rikonstruksion i pjesshëm i viles nr.30 Tiranë(rrjeti elektrik,hidraul,riparime ndërtimore)	13000	13000	13000
Mobilim i pjesshëm Vila 30 Tiranë	17000	17000	17000
Hidroizolim i tarracës së magazinës industriale Tiranë	2157	2157	2157
Hidroizolim i tarracës së Parkut, dhe lyerje të të gjitha ambienteve të tij	2140.1	2140.1	2140.1
Mobilim i plotë i Vilës Velipojë	19167	19167	19167
Rilevim topografik i trojeve në përdorim të DSHQ-së	6000	6000	6000
Rikonstruksion , mobilim i pjesës , rregullim i ambienteve të jashtme për pjesën e mbetur Vila Dhërmi	21000	21000	21000
Totali	406,552	406,552	406,552

-Përsa më sipër, propozohen këto investime duke ju referuar kërkesave më imediate të paraqitura, vlerën më të madhe në këto investime të kërkuara për tu realizuar me të ardhura nga buxheti i shteti e zë rikonstruksioni dhe adaptimi i ambjenteve të Pallatit të Kongreseve për mbledhjen e NATO-PA parashikuar për tu kryer në vendin tonë në 6/mujorin e I-rë të vitit 2016.

-Nisur nga kërkesa e vazhdueshme për përmirësimin e rrjeteve elektrike, hidraulike, tualeteve, mobilim të pjesshëm të sallës së ngrënies, sallës së ndenjes, ndërrim të perdeve dhe disa pajisjeve dhe orendive, pasi kjo rezidencë nuk po përdoret për banim sipas rregullit nga Kryeministri, por po përdoret për ambient për kryerjen e pritje përcjelljeve të Kryeministrit, kemi hartuar një preventive paraprak, investimi i llogaritur për tu kryer do ta bëjë këtë ambient më atraktiv dhe do të ndihmojë pozitivisht në krijimin e të ardhurave.

-Riparimet e tarracave janë të domosdoshme, pasi ato janë tejet të amortizuara dhe në gjendjen aktuale nuk sigurojnë kushtet për magazinim të materialeve.

-Mobilimi i vilës Velipojë është i domosdoshëm dhe do të kishte një ndikim pozitiv në krijimi e të ardhurave nga hoteleria, por gjithashtu nuk do të lejonte degradimin e investimit të kryer për rikonstruksionin e saj para 4 vitesh.

-Rilevimi topografik i trojeve në administrim të DSHQ-së do të krijonte kushte për hipotekimin dhe më shumë për saktësimin e këtyre pronave kërkesë e përsëritur edhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

-Gjithashtu, për përfundimin e punës së nisur në vitin 2015, pjesërisht më fonde të buxhetit të shtetit dhe të ardhurat e DSHQ-së, për kthimin e Vilës Dhërmi, në një ambient pushimi komod dhe brenda standardeve higjieno sanitare, kërkohet riparimi dhe mobilimi i pjesës së mbetur të mjediseve të brendshme dhe rikonstruksioni i pjesshëm i ambientit të jashtëm(lulishtes).

Në përfundim, projekt buxheti i vitit 2016, është hartuar duke u bazuar në kuadrin ligjor që përcakton detyrat e DSHQ-së, rregullon funksionimin normal të veprimtarisë së saj, por njëkohësisht dhe legjislacionit mbi përgatitjen e buxhetit.

Përgatitën relacionin

Kamelia VOJKA

Titullari i Institucionit

Arjana DOÇAJ

Drejtore e Nj .B. R. S. F



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERITARE

Nr. 137 Prot.

Tiranë, më 31 / 03 / 2015

Për: **Zotit Engjëll AGAÇI**
Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave
Tiranë

Lënda: Dërgim i Bilancit të vitit 2014 dhe i tabelave shoqëruese të tij

I nderuar zoti Sekretar i Përgjithshëm,


Në përmbushje të detyrimeve ligjore, ju lutem gjeni bashkëlidhur si më poshtë:

- Bilancin e vitit 2014
- Pasqyrat Financiare
- Raportin e Audituesit të Brendshëm
- Analizën Ekonomiko Financiare të Vitit 2014
- Deklaratën e gjeneruar nga sistemi informativ i Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë.

Në deklaratën e sipërcituar, për shkaqe të problematikave që ka vetë sistemi informativ, humbja e mbartur, në rubrikat e formularit, nuk pasqyrohet në mënyrë korrekte. Humbja e mbartur është ajo e paraqitur në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, që shoqëron Bilancin e vitit 2014.

Rezultati i Bilancit të vitit 2014, është rezultat pozitiv në vlerën + **14 648 099** lekë.
Dëshirojmë të nënvizojmë se rezultati i humbjes së vitit të kaluar ka qenë - **12 944 000** lekë.
Ky rezultat ekonomik pozitiv nuk është arritur gjatë dhjetëvjeçarit të fundit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin,


Kamelia VOJKA
DREJTORE

Konceptuar: A. Agaçi

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve, Tel. 42228398, Fax. 42232955

**FORMULAR I DEKLARIMIT DHE
PAGESES SE TATIMIT MBI FITIMIN**



(2) Periudha tatimore

14-A

(1) Numri Serial: _____

Numri i Vendosijes se Dokumentit (NVD)
(Vetem per perdorim zyrtar)

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT):

(3) J61828071I

Emri Tregtar i Personit te Tatueshem:

(4) DREJTORI E SHERB QEVERTARE

Emri Mbiemri i Personit Fizik:

(5)

Adresa:

(6) PJETER BOGDANI

Qyteti/Komuna/Rrethi:

Tirana, Tirane, Tirane

Numri Telefonit:

(7)

Lajmëroni nëse informacioni i mësipërm është jo i plotë ose ka ndryshuar

Llogaritja e rezultatit

Te ardhurat dhe shpenzimet

Të ushtrimit

Tatimore

(8/9) Te ardhurat

(8)	230,705,337	(9)	230,705,337
------------	-------------	------------	-------------

(10/11) Shpenzimet

(10)	216,057,237	(11)	216,057,237
-------------	-------------	-------------	-------------

(12) Shpenzimet e pazbritshme

		(12)	0
--	--	-------------	---

Rezultati

(13/14) Humbja

(13)	0	(14)	0
-------------	---	-------------	---

(15/16) Fitimi

(15)	14,648,100	(16)	14,648,100
-------------	------------	-------------	------------

(17) Humbje e mbartur

(17)	14,648,100
-------------	------------

(18) Fitimi i tatueshem neto (16-17)

(18)	0
-------------	---

Llogaritja e tatim fitimit

(19) Tatim fitimi me shkallen tatimore standarte

(19)	0
-------------	---

(20) Tatim fitimi me perqindje te tjera

(20)	0
-------------	---

(21) Tatim fitimi (19+20)

(21)	0
-------------	---

(22) Tatim fitimi i shtyre

(22)	0
-------------	---

(23) Tatim Fitimi i detyrueshem për t'u paguar

(23)	0
-------------	---



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERITARE

PASQYRAT FINANCIARE TË VITIT 2014

DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTARE
BILANCI FINANCIAR
31.12.2014

	A K T I V E T	USHTRIMI I MBYLLUR	USHTRIMI PARAARDHËS
	A K T I V E T		
I	AKTIVET AFATSHKURTRA		
1	MJETE MONETARE		
(i)	Mjete monetare në arkë	848.00	415.00
(ii)	Mjete monetare në bankë	17,636,996.02	12,075,054.97
(iii)	Të tjera mjete monetare		
	Totali 1	17,637,844.02	12,075,469.97
2	DERIVATIVE E AKTIVE FINANCIARE PËR TREGËTIM		
(i)	Derivative		
(ii)	Letra me vlerë të mbajtura për tregëtim		
	Totali 2		
3	AKTIVE TË TJERA FINANCIARE AFATSHKURTRA		
(i)	Llogari / Kërkesa të arkëtueshme	88,195,451.99	83,985,771.24
	llog. 411+412	82,794,854.28	80,087,729.62
	llog.421,423,471	5,400,597.71	3,898,041.62
(ii)	Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme		
	llog. 4454		
	llog. 444		
(iii)	Instrumente të tjera borxhi(Të drejta pag.)		
(iv)	Investime të tjera financiare		
	Totali 3	88,195,451.99	83,985,771.24
4	INVENTARI		
(i)	Lëndët e para	25,574,298.80	25,865,998.07
(ii)	Prodhim në proces		
(iii)	Produkte të gatshme	2,073,146.05	2,490,009.53
(iv)	Mallra për rishitje		
(v)	Parapagime për furnizime		
	Totali 4	27,647,444.85	28,356,007.60
5	AKTIVET BIOLOGJIKE AFATSHKURTRA		
6	AKTIVET AFATSHKURTRA TË MBAJTURA PËR SHITJE		
7	PARAPAGIMET DHE SHPENZIMET E SHTYRA		
	TOTALI I AKTIVEVE AFATSHKURTRA (I)	133,480,740.86	124,417,248.81
II	AKTIVET AFATGJATA		
1	INVESTIMET FINANCIARE AFATGJATA		
(i)	Aksione e pjesëmarrje në njësi të kontrolluara		
(ii)	Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje		
(iii)	Aksione dhe letra të tjera me vlerë		
(iv)	Llogari / Kërkesa të arkëtueshme afatgjata		
	Totali 1		
2	AKTIVE AFATGJATA MATERIALE		
(i)	Toka	2,749,547,200.00	2,749,547,200.00
(ii)	Ndertesa	389,281,160.49	409,721,621.49
(iii)	Makineri e pajisje	36,496,842.30	37,220,246.70
(iv)	Aktive të tjera afatgjata materiale	83,471,116.99	100,278,800.99
	Totali 2	3,258,796,319.78	3,296,767,869.18
3	AKTIVET BIOLOGJIKE AFATGJATA		
4	AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE		
5	KAPITALI AKSIONAR I PAPAGUAR		
6	AKTIVE TË TJERA AFATGJATA		
	TOTALI I AKTIVEVE AFATGJATA (II)	3,258,796,319.78	3,296,767,869.18
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)	3,392,277,060.64	3,421,185,117.99

DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTARE

DETYRIMET DHE KAPITALI		USHTRIMI I MBYLLUR	USHTRIMI PARAARDHËS
DETYRIMET			
I	DETYRIMET AFATSHKURTRA		
1	DERIVATIVET		
2	HUAMARRJET		
(i)	Huatë dhe obligacionet afatshkurtra		
(ii)	Kthimet/Pagesat e huave afatgjata		
(iii)	Bono të konvertueshme		
	Totali 2		
3	HUATE DHE PARAPAGIMET		
(i)	Të pagueshme ndaj furnitoreve 401		
(ii)	Te pagueshme ndaj punonjesve	32,343,729.93	40,394,510.74
(iii)	Detyrime tatimore	326,959.48	3,559,625.48
(iv)	Huara të tjera	5,539,444.00	2,560,648.14
(v)	Detyrime të tjera (diferenca çmimi)	3,382,091.20	3,758,470.41
	Totali 3	485,098.95	
		42,077,323.56	50,273,254.77
4	GRANDET DHE TE ARDHURAT E SHTYRA		
5	PROVIZIONET AFATSHKURTRA		
	TOTALI I DETYRIMEVE AFATSHKURTRA (I)		
II	DETYRIMET AFATGJATA		
1	HUATE AFATGJATA		
(i)	Hua, bono dhe detyrime nga qiraja financiare		
(ii)	Bonot e konvertueshme		
	Totali 1		
2	HUAMARRJE TE TJERA AFATGJATA		
3	PROVIZIONET AFATGJATA	29,400,000.00	29,400,000.00
4	GRANDET DHE TE ARDHURAT E SHTYRA	417,591,093.58	452,951,319.22
	TOTALI I DETYRIMEVE AFATGJATA (II)		
	TOTALI I DETYRIMEVE (I + II)	446,991,093.58	482,351,319.22
	KAPITALI		
1	Aksionet e pakicës		
2	Kapitali që i përket aksionareve të shoqërisë mëmë		
3	Kapitali aksionar		
4	Primi i aksionit	2,963,261,000.00	2,963,261,000.00
5	Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)		
6	Rezerva statutore		
7	Rezerva ligjore		
8	Rezerva të tjera	5,009,746.00	5,009,746.00
9	Fitimet (Humbjet) e mbartura	94,624,886.19	94,624,886.19
10	Fitimi (Humbja) e vitit financiar	- 174,335,088.19	- 161,392,268.54
		14,648,099.50	12,942,819.65
	TOTALI I KAPITALIT (III)	2,903,208,643.50	2,888,560,544.00
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)	3,392,277,060.64	3,421,185,117.99

Nj.B.R.S.T.
Ariana Doçaj



DREJTORE

Kamelia Vojka






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTARE

Të dhëna për shoqërinë

Drejtorja e Shërbimeve Qeveritare Tiranë, është krijuar si ndërmarrje shtetërore në varësi të Këshillit të Ministrave. Organizimi dhe funksionimi i saj bazohet në ligjin „Për ndërmarrjet shtetërore „ si dhe në V.K.M. nr.34 datë 07.01.1999, dhe ndryshimet e mëvonshme të tij:

- VKM nr 678, datë 15.12.2000,
- VKM nr 399, datë 22.8.2002,
- VKM nr 411, datë 11.07.2007,
- VKM nr.5 datë 4.01.2012,

Drejtimi i Institucionit realizohet nga Këshilli Drejtues dhe Drejtori. Objekti kryesor i veprimtarisë së saj është kryerja e shërbimeve qeveritare, trajtimi i personaliteteve të larta të shtetit dhe miqve të ftuar të Shqipërisë.

Gjatë periudhës nga 01.01.2014 deri më 31.12.2014 shoqëria ka kryer aktivitetin e saj në përputhje me objektin e krijimit të saj.

Në fund të vitit ushtrimor 2014 numri i punonjësve në këtë ndërmarrje është 194.

Të dhëna për Pasqyrat Financiare

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me nenin 4 të Ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 " Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare " i ndryshuar si dhe Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 4292 datë 15.06.2006, "Për shpalljen e Standarteve Kontabël Kombëtare dhe zbatimin e detyrueshem të tyre ". Kjo sepse ndërmarrja jone plotëson kushtet që të zbatojë SKK.

Hartimi i tyre është bërë mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara dhe parimit të vijimësisë duke respektuar karakteristikat e tyre cilësore :

- Kuptueshmërinë, për të qenë informuese e pa ekuivoke për përdoruesit.
- Rëndësinë, duke paraqitur vetëm atë informacion që ndikon në vendimet e përdoruesve.
- Besueshmërinë, duke dhënë informacionin të plotë, të paanshëm, të vlerësuar me kujdes ku përmbajtja ekonomike ka përparësi ndaj formës ligjore.
- Krahasueshmëria, shifrat e dy periudhave të përfshira në pasqyrat financiare janë të krahasueshme.

Janë përpiluar 4 pasqyrat kryesore :

1. Bilanci
2. Pasqyra e të Ardhuarve dhe Shpenzimeve
3. Pasqyra e Flukseve të Parasë
4. Pasqyra e ndryshimeve në kapital.

Të 4 pasqyrat janë përgatitur për periudhën 01.01.2014- 31.12.2014 janë paraqitur në lekë pa përdorur rrumbullakim shifrash. Për llogaritë në valutë (€uro) tepricat u janë rivlerësuar më datë 31/12/2014 me kursin e Bankës së Shqipërisë në këtë datë 1 €uro = 140.14 lekë dhe 1 \$ = 115.23 lekë.

Shënimet shpjeguese do të japin informacion të hollësishëm dhe të nevojshëm mbi pothuajse të gjithë zërat e pasqyrave.

SHËNIMET SHPJEGUESE

1. Shënime shpjeguese mbi politikat kontabël

Në përputhje me SKK, politikat kontabël që janë zbatuar në përgatitjen e pasqyrave financiare janë në përputhje me parimet bazë të përshkruara në Ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare " i ndryshuar.

2. Shënime shpjeguese mbi zërat e pasqyrave kryesore

Sipas SKK 2 " Paraqitja e Pasqyrave Financiare " renditja e sqarimeve të veçantë të pasqyrave financiare në këto shënime janë bërë në përputhje me renditjen e tyre në pasqyrat financiare.

Bilanci

